



Programi i Bursave ICDF për Arsim të Lartë Ndërkombëtar në Tajvan është i hapur për aplikim nga 1 janar 2016 deri 18 mars 2016

Edukimi dhe trajnimi ndërkombëtar ka qenë prej kohësh një nga operacionet bazë të ICDF në Tajvan, në mesin e shumë të tjerave. Programet zhvillimore të burimeve njerëzore luajnë një rol jetik në ndihmën e vendeve partnere për të arritur zhvillim të qëndrueshëm, dhe arsimimi është një mekanizëm kyç për trajnimin e fuqisë punëtore për vendet në zhvillim. ICDF në Tajvan ofron bursa për arsimin e lartë dhe ka zhvilluar programet universitare, pasuniversitare dhe Ph.D. në bashkëpunim me universitetet partnere me renome në Tajvan. Qytetarët e Kosovës kanë të drejtë të aplikojnë për programet pasuniversitare dhe Ph.D. përmes Zyrës Përfaqësuese së Taipei-it në Hungari.

Përfitimet nga bursat

Të drejtat: ICDF në Tajvan i ofron çdo marrësit të bursave një bursë të plotë, duke përfshirë biletën kthyesë të aeroplanit, strehimin, tarifat e shkollimit dhe kredive, sigurimin, kostot e teksteve shkollore dhe një kompensim mujor. Më shumë informata mund të gjenden në faqen e internetit të [ICDF Tajvan](#).

Njoftim i rëndësishëm:

1. Aplikantët duhet të aplikojnë për te dy rastet: si për bursë të ICDF, gjithashtu edhe për programet Universitare që ata kanë qëllim për ti studiuar.
2. Kontrolli Mjekësor është i domosdoshëm për aplikimin në ICDF.
3. Qytetarë nga Kosova kanë të drejtë të aplikojnë për programet Master ose PhD, që të renditura në dokumentin e bashkangjitur, por jo edhe për programet Bachelor. Çdo aplikant mund të aplikojnë vetëm për një program.
4. Pakoja origjinale e aplikimit duhet të dërgohet me postë në Zyrën Përfaqësuese të Taipei-it në Hungari, jo më vonë se 18 mars, 2016. Aplikimi përmes email-it nuk është i pranueshëm. [Apliko tani](#)

Adresa e Zyrës Përfaqësuese së Taipei-it është:
Taipei Representative Office in Hungary
Rakocziut 1-3
Budapest 1088
Hungary